

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafi 6, dhe nenin 24, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 shkurt 2021, miratoi këtë

UDHËZIM

PËR PËRDORIMIN E FORMULARIT MBI PREJARDHJEN E FONDEVE DHE PËRCAKTIMIN E MBAJTËSIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë mënyrën e përdorimit të formularit mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë (në vazhdim: formulari), në zbatim të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (në vazhdim: Ligji për PPP/LFT).

Neni 2

Fushëveprimi

Formulari zbatohet nga të gjitha bankat dhe institucionet e tjera financiare sipas Ligjit për PPP/LFT.

Neni 3

Përdorimi i formularit

1. Formulari përdoret në pajtim me nenin 19, paragrafi 6, dhe nenin 24, paragrafi 2, nënparagrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.6, të Ligjit për PPP/LFT, për të identifikuar klientët sipas specifikave të formularit, përpara se:
 - 1.1. të krijojnë marrëdhënie afariste;
 - 1.2. kur realizojnë transaksione të rastit në para të gatshme në vlerë prej dhjetë mijë (10.000) euro ose më shumë, apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse është kryer si një transaksion i vetëm ose disa transaksione që janë të ndërlidhura. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi bëhet në momentin kur shuma monetare bëhet e njohur apo pragu është arritur;
 - 1.3. të hapin një llogari bankare;
 - 1.4. të pranojnë aksione, bono thesari ose letra të tjera me vlerë për t'i ruajtur në kasafortë;
 - 1.5. të ofrojnë lehtësira për depozita të sigurta;
 - 1.6. të angazhohen në çdo transaksion të vetëm apo të ndërlidhur, në para të gatshme, në vlerën prej dhjetë mijë (10.000) euro ose më shumë. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si një transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë kryer nga ose në emër të një personi ose subjekti dhe shuma e përgjithshme prej dhjetë mijë (10.000) euro ose më shumë është bërë në një ditë të vetme.
2. Personi (-at) i (e) përfshirë në një aktivitet sipas dispozitave të nenit 19.6 të Ligjit për PPP/LFT duhet të sigurojnë bankën ose institucionin financiar, me anë të formularit të caktuar nga BQK-ja, se ai/ajo po vepron:
 - 2.1. në emër të tij ose të saj si pronar dhe mbajtës i të drejtës së pronësisë mbi çdo pronë që i nënshtrohet transaksionit; ose
 - 2.2. si një agjent i autorizuar i një ose më shumë personash ose subjektsh në pajtim me paragrafin 3, nënparagrafët 3.1 dhe 3.2, të nenit 19 të Ligjit PPP/LFT, pasi të ketë marrë masat e duhura për të verifikuar se secili person ose subjekt është pronar ose

mbajtës i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit dhe ka mirëbesimin se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronari dhe/ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit.

Neni 4

Aplikimi i formularit nga bankat dhe institucionet financiare

1. Bankat dhe institucionet financiare për nevoja të zbatimit praktik konform dispozitave ligjore, formularin e përdorin në kuadër të proceseve dhe procedurave të brendshme.
2. Bankat dhe institucionet financiare, pas masave të kujdesit të duhur sipas Ligjit për PPP/LFT, mund të zbatojnë përdorimin e formularit edhe në formë elektronike (ATM dhe pajisje tjera). Bankat dhe institucionet financiare zhvillojnë sistemet e tyre në atë mënyrë që integrojnë kërkesat e këtij udhëzimi dhe formularit në pajisje të ndryshme elektronike të tyre (ATM dhe pajisje tjera), japin mundësi dhe pranojnë nga klientët deklarin mbi burimin e prejardhjes së fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë, duke ofruar opsione të nevojshme dhe të mjaftueshme.
3. Formulari duhet të aplikohet nga të gjitha bankat dhe institucionet tjera financiare.

Neni 5

Përjashtimet

1. Bazuar në Ligjin për PPP/LFT, neni 23, bankat dhe institucionet financiare pas zbatimit të politikave dhe procedurave të njohjes së klientit, në procesin e kryerjes së transaksioneve nga klientët të cilët janë kompani në pronësi publike, ushtrojnë kujdesin e duhur të thjeshtësuar, dhe atë për:
 - 1.1. Transaksione të cilat realizohen për pagesa të obligimeve komunale të cilat ofrohen nga kompanitë në pronësi publike dhe për të gjitha rastet e transaksioneve në para të gatshme që janë të paraqitura nga kompanitë në pronësi publike.

2. Për transaksione në para të gatshme për polica të sigurimit të cilat janë ligjërisht obligative si policat e sigurimit për vetura dhe pagesave të regjistrimit në fakultet apo pagesave tjera për qëllime të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë.
 - 2.1. Bankat dhe institucionet financiare sigurojnë që do të ushtrojnë monitorim të mjaftueshëm të transaksioneve apo marrëdhënieve afariste për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonshme ose të dyshimta.

Neni 6

Shtojca

Shtojca e këtij udhëzimi është Formulari mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë.

Neni 7

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet Udhëzuesi për përdorimin e formularit mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë, i cili është zbatuar nga data 15 shkurt 2012.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 mars 2021.



Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

FORMULAR MBI PREJARDHJEN E FONDEVE DHE PËRCAKTIMIN E MBAJTËSIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË

DEKLARATË MBI PREJARDHJEN E FONDEVE

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, përkatësisht nenin 19.6 (Kujdesi i duhur ndaj klientit) dhe Rregulloren e BQK-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, neni 18.5 (Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientit), personi i përfshirë në transaksion duhet të sigurojë me shkrim bankën ose institucionin financiar se:

- I. Çfarëdo pasurie që është subjekt i transaksionit rrjedh nga aktivitetet ligjërish të lejuara (evidento me anë të përshkrimit prejardhjen e fondeve dhe mundësisht këtij formulari bashkëngjithi ndonjë dokument relevant që e vërteton deklarinin tënd):

Shuma e transaksionit:

Valuta:

- II. Personi i përfshirë në transaksion dëshmon se:

- A. Vepron në emër të tij ose të saj si pronar dhe mbajtës i të drejtës së pronësisë mbi çdo pronë që i nënshtrohet transaksionit;
- B. Vepron si një agjent i autorizuar (ose si palë e tretë e pavarur) i një ose më shumë personash ose subjektsh: _____

DEKLARATË MBI PËRCAKTIMIN E MBAJTËSIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, përkatësisht nenin 19.6 (Kujdesi i duhur ndaj klientit), dhe Rregulloren e BQK-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, neni 18.5 (Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientit), personi i përfshirë në këtë aktivitet duhet të sigurojë me shkrim bankën ose institucionin financiar se:

- I Personi i përfshirë në këtë aktivitet dëshmon se:
- A. Vepron në emër të tij ose të saj si pronar dhe mbajtës i të drejtës së pronësisë mbi çdo pronë që i nënshtrohet transaksionit;
- B. Vepron si një agjent i autorizuar (ose si palë e tretë e pavarur) i një ose më shumë personash ose subjektsh:

Emri dhe Mbiemri

Profesioni

Nr. i identifikimit personal

Adresa

Nënshkrimi

Data

Vendi